



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr.281, datë 25.05.2023

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË
NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE,
TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 502 DATË 21.11.2022, TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.05.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale

2. Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë për në Gjykatës e Apelit Tiranë, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 21.11.2022, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 05.12.2022.

3. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

4. Më datë 10.02.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi

5. Brenda afatit të përcaktuar kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 23.02.2023, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

7. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidati duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pranë ILDKPKI-së.

8. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 09.03.2023, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidatin z. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

9. Me Vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 Këshilli ka vendosur fillimin e procedurave të verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022, përfshirë edhe për kandidatin z. {...}. Në këtë rast, për realizimin e procedurës së verifikimit të kandidatit në fjalë, me short, si relator, është caktuar anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Alban Toro. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e

kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019), si dhe pikën 9, të Vendimit nr.502 datë 21.11.2023, relatori kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidatit në lidhje me tre kriteret formale¹ të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak, me Vendimin nr. 209, datë 26.04.2023, Këshilli vendosi:

1.Verifikimin e plotësisë nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2.Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022.

10. Pas vendimmarrjeve të më sipërme të Këshillit, kandidati është në procedurë vlerësimi profesional dhe etik, e cila po realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, procedurë e cila po zhvillohet paralelisht me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës së këtij kandidati në kuadër të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

11. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022, është përcaktuar se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: “c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

12. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, pas kërkesave konkrete, Institucionet kompetente kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

¹ Tre kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit Tiranë janë: “përvoja profesionale minimale”, “mospasja masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

13. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës për kandidatin {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 08.05.2023, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

14. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 08.05.2023 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurave të mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022 ose skualifikimin e kandidatit dhe përjashtimin e tij nga procedurat e ngritjes në detyrë në këtë pozicion në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE TË FIGURËS

15. Neni 48, pika 7 dhe pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcakton se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

16. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, në Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019). Pasur pasqyrisht faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “*ex officio*”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidojnë për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

17. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, titulluar “Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr.84/2016”, përcaktohet se: “1. Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij Seksioni, kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, do t'i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për

dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. 4. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. ... 6. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, fillojnë pas afatit 180 ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të Ligjit nr.9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë. 7. Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”.

18. Sa sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Megjithatë, në rastin e kandidati që i është nënshtruar dhe ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, verifikimi për të i pasurisë dhe figurës sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, do të shtrihet për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar.

19. Rezulton se kandidati, z. {...} i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me Vendimin nr. 596, datë 09.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton të ketë marrë formë të prerë më datë 21.01.2023, pasi nuk u ankimua. Ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe mban datën 23.01.2023. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidat u shtri për periudhën 25.01.2017 deri më 28.02.2023.

A. Për kriterin e pasurisë

20. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32², të Ligjit për Statusin, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.

² “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose

21. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 43/23 prot., datë 02.05.2023.

21.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

21.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrolle të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, për periudhën pas dhënies së vendimit nga ana e organeve të rivlerësimit, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

22. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

22.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 4011/2 prot., datë 24.03.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. 1776/11 prot., datë 29.03.2023 ku për kandidatin {...} nuk rezulton të jetë i regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...".

22.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 4560/1 prot., datë 11.04.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. 1776/14 prot., datë 12.04.2023, ku për kandidatin {...}, nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

23. Në kushtet kur nga informacionet respektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk jepej ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kandidatin, u vlerësua se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

24. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

25. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë

B. Për kriterin e figurës

26. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit.

27. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

28. Nga raportimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas shkresës nr. 263/1 prot., datë 24.03.2023 protokolluar në Këshill me aktin nr.1776/10 prot., datë 27.03.2023, nuk rezultoi ndonjë informacion i vlefshëm për qëllimet e verifikimit për kandidatin z. {...}.

29. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, në kushtet kur ky kandidat ka qenë magjistrat në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidati i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

30. Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me Shkresën nr. 1732/4 prot., datë 13.03.2023, ku për kandidatin {...} është bërë me dije se: - ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 03.05.2016; -formulari është regjistruar me numrin unik 000373- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të dhënave gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara; - deri më sot nuk ka pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

31. Kandidati z.{...} nuk iu nënshtrua verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në kushtet kur ai nuk është e vitlindjes më të hershme se Korrik 1977 (kandidati është e vitlindjes 1983), sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019.

32. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;

- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit, përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij, mbi të cilat mund të gjykohej për pranueshmërinë ose jo të tij për ngritjen në detyrë si gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

III. KONKLUZIONE

33. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

34. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 502 datë 21.11.2022.
2. Vendimi nr. 209, datë 26.04.2023, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR